

VENDIM
Nr. 73, datë 2.12.2020

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE FINANCIARE SHITESË NGA BANKA AMERIKANE E
INVESTIMEVE SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “vii”, nenit 54, pika 2, shkronja “ë”, si dhe nenit 54, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 45, paragrafët e dytë dhe të katërt, të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a. të veprimtarive financiare shitesë të:

a) tregimit, për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

- pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;

b) shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimeve të tjera ndihmëse, për veprimtarinë e mësipërme, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.

3. Banka do të ushtrojë veprimtarinë financiare të përcaktuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij vendimi, pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko